



999/11
24.07.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SHËRBIMI LEGJISLATIV
SHËRBIMI JURIDIK

Nr. 1334/3 Prot.

Tiranë, më 23.07 2026

Lënda: Dërgim rezolute dhe shkrese përcjellëse

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026”, si dhe shkresën përcjellëse të Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale “Mbi zbatimin e rekomandimeve të miratuara në rezolutën e Kuvendit të Shqipërsë”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONCAJ





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

**KOMISIONI PËR NISMAT QYTETARE, BASHKËPUNIMIN DHE MBIKËQYRJEN
INSTITUCIONALE**

Nr. 1334/Prot.
3

Tiranë, më 23.07.2026

Lënda: Mbi zbatimin e rekomandimeve të miratuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë.

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë

Në përmbushje të funksionit kushtetues të kontrollit parlamentar Kuvendi i Shqipërisë, në mbështetje të nenit 103 të Rregullores së tij, në seancë plenare ka miratuar Rezolutën me Rekomandimet për vitin 2026 për institucionin tuaj, e cila po ju përcillet bashkëlidhur.

Komisioni i përhershëm parlamentar “Për nismat qytetare, bashkëpunimin dhe mbikëqyrjen institucionale” në përputhje me fushën e tij të përgjegjësisë ndër të tjera ka si kompetencë edhe “Monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të strategjive, rezolutave, vendimeve dhe planeve të veprimit të Kuvendit”.

Në rekomandimet e miratuara është parashikuar detyrimi i institucionit tuaj që “Brenda 30 ditësh nga miratimi i rezolutës, të hartojë dhe publikojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, i cili të përcaktojë masat konkrete, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse, treguesit bazë dhe objektivat e synuar, si dhe të raportojë periodikisht mbi nivelin e përmbushjes së tyre”. Mirëpresim nga ana juaj dërgimin brenda datës 31 gusht të këtij plani veprimi.

Për të mundur bashkëpunimin në procesin e monitorimit periodik të progresit të zbatimit të rezolutës dhe shkëmbimin e informacionit përkatës Komisioni do të vazhdoj komunikimin institucional përmes pikës së kontaktit të përcaktuar prej jush. Nëse keni ndryshime në këtë aspekt ju lutem na i bëni me dije brenda datës 31 korrik, në adresën e emailit: komisioni.nisma.monitorimi@parlament.al.

Për çdo sqarim të mëtejshëm, në kuadër të këtij procesi mund të kontaktohet Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve, në Kuvend.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Fatmir XHAFAJ

KRYETAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Niko PELESHI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë, si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke vlerësuar si veçanërisht të rëndësishme rritjen e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme, ku energjia nga burimet fotovoltaike tashmë përfaqëson rreth 18% të kapacitetit të instaluar në vend dhe gjatë vitit 2025 gjeneroi një prodhim prej 832.3 GWh, një hap i rëndësishëm drejt një sistemi energjetik të diversifikuar, më të pastër dhe më të qëndrueshëm;

Duke vlerësuar se sistemi energjetik shqiptar ka vijuar të përmirësojë performancën e tij dhe konkretisht në sistemin e transmetimit të operuar nga OST sh.a., humbjet teknike u ulën në 1.9%, ndërkohë në rrjetin e shpërndarjes të administruar nga OSSH sh.a., humbjet zbritën në 16.96%;

Duke konsideruar që një liberalizim i mëtejshëm i tregut të energjisë elektrike synon një siguri më të lartë furnizimi dhe një zhvillim më të mirë të tregut të energjisë elektrike;

Shqyrtoi veprimtarinë e Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2025 dhe vlerëson:

Vendimmarrjen në lidhje me çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë për vitin 2025, ulja e çmimit ka impakt të drejtpërdrejtë në afro 87% të klientëve familjarë, konsumi i të cilëve është nën 700 kWh/muaj.

Punën e bërë për të adresuar sfidat që lidhen me promovimin dhe integrimin e projekteve për impiantet e prodhimit të energjisë elektrike për vetëprodhuesit. Rritja e prodhimit të energjisë nga impiantet fotovoltaike (11% të prodhimit total vendas për vitin 2025) përmirëson sigurinë energjetike të vendit duke diversifikuar burimet e energjisë.

Punën e bërë për fushatat promovuese për modalitetet e funksionimit të Platformës së Krahimit të Çmimeve (PCT) në tregun e lirë, si një hap të rëndësishëm i cili siguron transparencë dhe konkurrencë në treg, duke mbrojtur interesat e konsumatorëve.

Rritjen e aktivitetit të tregtimit të bursës ALPEX, si në numër të ofertave, ashtu dhe në volumin e tyre, të cilat arrijnë në gati 9.5 % të totalit të tregut (për zonën e Shqipërisë).

Punën e bërë për miratimin e “Strategjisë për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative për vitet 2025–2030”, e cila përcakton objektivat, masat dhe instrumentet që do të përdoren për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për kursimin e energjisë dhe për të promovuar përdorimin e burimeve alternative të energjisë.

Punën e bërë për miratimin e ndryshimeve në standardet e cilësisë së shërbimit për sistemin e transmetimit. Ndryshimet e bëra përfshijnë treguesit që lidhen me performancën dhe sigurinë e rrjetit të transmetimit të operuar nga OST sh.a. dhe ndikojnë në përmirësimin e cilësisë për konsumatorët.

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Enti Rregullator i Energjisë për vitin 2026 në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve dhe të përmirësimit të shërbimeve të operatorëve të energjisë, të rrisë përpjekjet që brenda vitit 2026 Platforma Digjitale për trajtimin dhe gjurmimin e zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve të jetë funksionale dhe në shërbim të konsumatorëve, duke bërë të mundur jo vetëm adresimin *online* të ankesave, por edhe ndjekjen në çdo kohë të procesit të shqyrtimit nga ERE, adresimit të kërkesave të ERE-s tek të licencuarit, përgjigjen e të licencuarit e deri në përfundimin e procesit.

2. Të marrë masa rregullatore për përmirësimin e standardeve të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë, duke synuar rritjen e treguesve të performancës, uljen e kohës mesatare të ndërprerjes, si dhe përmirësimin e treguesve që lidhen me cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe furnizimin e tyre me energji në parametra teknikë sipas standardeve.

3. Në kuadër të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *acquis*-n e BE-së, të vijojë përpjekjet dhe bashkëpunimin me të gjithë aktorët për të bërë të mundur transpozimin e Paketës së Integritetit të Energjisë (EIP), si dhe liberalizimin e plotë të tregut me pakicë të energjisë elektrike.

4. Gjatë procesit të shqyrtimit të planeve të investimeve të OSSH-së dhe OST-së, të ketë në fokus, nga njëra anë, rritjen e kapaciteteve transmetuese, përmirësimin e fleksibilitetit operacional të sistemit elektroenergjetik dhe njëkohësisht të fokusohet edhe në garantimin e një furnizimi sipas standardeve cilësore, të qëndrueshëm dhe të pandërprerë në zonat me intensitet të lartë zhvillimi, përfshirë edhe zonat turistike.

5. Me hyrjen në fuqi të metodologjisë “Për vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike”, me qëllim për të siguruar kushte të favorshme për pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm dhe integrimin e burimeve të rinovueshme në sistemin energjetik, të marrë masa për të kryer vlerësimin e parë të gatishmërisë së tregut, duke marrë parasysh ndër të tjera edhe tregun e bashkuar Shqipëri – Kosovë.

6. Të forcojë monitorimin e Bursës ALPEX, duke vlerësuar indikatorët e transparencës, konkurrencës dhe efikasitetit të tregut dhe të ndërmarrë veprime rregullatore kur vërehen devijime nga standardet dhe në të njëjtën kohë të vijojë përpjekjet për rritjen e volumit të tregtimit të bursës ALPEX, në funksion të një tregu transparent, i cili nxit investimet në Energjinë e Rinovueshme dhe rrit konkurrencën e ndershme.

7. Të marrë masa për krijimin e një sistemi me *template* të standardizuar për raportimin e bilanceve energjetike nga operatorët e licencuar, për të bërë të mundur krijimin e një baze të dhënash më të saktë dhe më të konsoliduar për t’u analizuar, e cila ndikon në përmirësimin e inspektimeve të rregullatorit.

8. Të punojë për zhvillimin e një hapësire të dedikuar në faqen zyrtare të institucionit, ku të publikohen materiale informuese dhe udhëzuese për eficiencën e energjisë, të cilat kanë si qëllim informimin e publikut dhe aktorëve të tregut, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe në promovimin e praktikave të mira për përdorimin racional të energjisë.

9. Të marrë masat që menjëherë pas miratimit të metodologjisë nga Këshilli i Ministrave të miratojë çmimin e energjisë elektrike të prodhuar nga vetëprodhuesit, si dhe të luajë një rol proaktiv dhe të intensifikojë bashkëpunimin me të gjithë aktorët dhe palët e interesit, me qëllim adresimin e sfidave dhe standardizimin e proceseve që lidhen me promovimin dhe integrimin e projekteve të vetëprodhuesve, duke rritur sigurinë energjetike dhe uljen e ekspozimit të sistemit ndaj kushteve klimatike.

10. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit, në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të këtij viti.

Miratuar në datën 16.7.2026